



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

Nr. 34 Prot

Tiranë, më 10/10/2022

Lënda: Raporti vjetor Agjencia e Trajtimit të Kredive, Viti 2021

Drejtuar: **ZNJ. Delina IBRAHIMAJ**

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Për dijeni: **ZNJ. Adela XHEMALI**

ZV. MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Z. Arlind GJOKUTAJ

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM,
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Të nderuar,

Në zbatim të Ligjit Nr. 8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 33, datë 24.09.2010 dhe Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, në vijim të procesit të raportimit, ju paraqesim raportin vjetor, për periudhën Janar - Dhjetor 2021 mbi realizimin e treguesve financiar dhe statistikor.

HYRJE

Performanca e ATK-së, në realizimin e objektivave u orientua sipas planit të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës për Vitin 2021 dhe sipas pikave si më poshtë:

Realizimi me sukses i këtij misioni ka prioritet në:

- Zgjidhjen me sukses për kërkesat ndaj debitorëve
- Trajtimi ligjor i dosjeve
- Nxjerrja e pronave në ankand dhe Risku
- Marrëveshjet ndërinstucionale
- Arkëtojnë në favor të shtetit fondet e parashikuara në proces të saj me kosto sa më të ulët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

➤ **Treguesit e arkëtimeve dhe performancës, sqarime mbi to**

Në kuadër të realizimit të objektivave për vitin 2021, ATK-ja ka vënë në funksion masat administrative, për të përmirësuar punën dhe zgjidhur problematikat e krijuara. Në bashkëpunim me sektorët përgjegjës, ka vijuar puna me takimet në terren me debitorët, thuajse në të gjitha qarqet dhe bashkitë e vendit, për të mundësuar arkëtimet sipas planit, por edhe duke negociuar dhe duke iu bërë me dije sidomos lehtësirat që iu ofron ligji për faljen e interesave.

Gjatë periudhës 12-mujore, një vëmendje e posaçme i është kushtuar ndjekjes ligjore dhe trajtimit të huamarrësve, natyrisht edhe takimet me debitorët dhe orientimi i tyre drejt shlyerjes së detyrimit, duke i bërë me dije lehtësirat që ofron ligji në faljen e interesave. Konkretisht deri më tani janë dërguar rreth 5000 “Njoftime Detyrimi” për debitorët, dhe janë dërguar 500 dosje të reja në Zyra Përmbarimore Private dhe Shtetërore për ekzekutim në mënyrë të detyrueshme.

- **Gjatë Vitin 2021 janë ekzekutuar 119 dosje dhe përlogaritja në kontabilitet është si më poshtë:**

Muaji/Viti	Janar	Shkurt	Mars	Pull	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Etor	Nëntor	Dhjetor	Total	N. vlers	
Dosje të mbyllura 2020	17	4	0	3	3	4	10	4	6	11	2	8	72	14	115,389
Dosje të mbyllura 2021	8	4	14	22	4	7	6	6	6	14	11	17	119		226,302

- **Realizimi i të ardhurave nga arkëtimet e detyrimeve të debitorëve për periudhën Janar - Dhjetor 2021 është si më poshtë:**

Progresiv Janar - Dhjetor 2021

Plan	Fakt	%
90,000,000	77,643,154	86

Në vitin që u mbyll është realizuar pagesa e një pjesë detyrimi të prapambetur për KFW-në, në shumën 167,432.03 Euro dhe synohet që në vijim, me realizimin e targetit në një përqindje sa më të lartë do të ketë sërish përpjekje për të shlyer tjetër këst të konsiderueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

➤ Problematikat dhe zgjidhja

Gjatë Vitit 2021, janë caktuar detyra me plane afatshkurtër dhe afatgjatë për trajtimin e të gjithë debitorët në ekzekutim, të cilat në përfundim rezultuan efikase në realizimin e planit në masën 86%. Prioritet ka qenë dërgimi dhe ndjekja për ekzekutim në zyrat e shërbimit përmbartimor, shtetëror dhe privat i praktikave të debitorëve. Nga bashkëpunimi ndërinstytucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror, ka qenë edhe më i lehtë evidentimi i debitorëve dhe ekzekutimi i detyrimit, pasi në qytetet ku ushtrojnë funksionin na suportojnë në kontaktin e drejtpërdrejtë me debitorin dhe realizimin e arkëtimeve për ATK-në. Do të vazhdohet me negociatat për rifreskimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ASHK-në, lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me RBS si dhe me institucione të tjera.

Në funksion të realizimit të tyre do të krijojmë mundësitë për marrëveshje bashkëpunimi, ku me rëndësi do të ishte edhe ajo me AKEP për numrat e kontaktit të debitorëve. E gjitha kjo i shërben një strategjie, afat-mesme dhe afat-gjatë që ka Agjencia e Trajtimit të Kredive në trajtimin ligjor të debitorëve dhe realizimin e targetit, jo vetëm të muajit pasardhës por edhe atij vjetor.

Grupet e punës në terren kanë vijur punën duke verifikuar kolateralet e lëna nga debitorët si garanci për marrjen e kredisë, të cilat në shumicën e rasteve kanë parregullsi dokumentacioni. Vështirësi krijojnë edhe zyrat e ASHK-së, pasi me ndryshimet ligjore të tyre nuk ofrojnë lehtësira bashkëpunimi.

Portofoli dhe numri i debitorëve të mbetur për trajtim nisën që të grupohen e klasifikohen, sikundër është vepruar konkretisht deri tani; pra, sipas madhësisë së detyrimit, objektit të kredisë, llojit të kolateralit e kështu me radhë. Bazuar tek objekti i kredisë, numrin më të madh e zënë debitorët e zonave rurale, ku vetëm ata me objekt kredie “për bujqësi e blegtori” dhe “për mjete bujqësore” shkojnë në total në 6090 raste.

Në vijim të raportimit, ju vëmë në dijeni edhe mbi problematikat aktuale që ka institucioni ynë në mbarëvajtjen e funksionimit.

Kemi kërkuar edhe mbështetje nga OSSHE dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, por nuk kanë suportuar në lehtësirat për gjetjen e debitorit, duke bërë që të kontaktojmë vetë në terren deri në zonat informale, ashtu sikundër kemi edhe vonesa nga ASHK!

Problematikë mbetet edhe rritja e numrit të proceseve gjyqësore. Proceset gjyqësore të ngritura nga debitorët janë me objekt-padie për: “pavlefshmëri titulli detyrimi” për pretendim të plotësimit të afatit të parashkrimit, për shkak se janë kredi të cilat janë dhënë para më shumë se 25 viteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

Proceset gjyqësore ndiqen me prioritet nga ana e institucionit, ku përfaqësohemi në çdo seancë, me synim rikuperimin e debisë. Vëmë në dukje se Agjencia e Trajtimit të Kredive përfaqësohet në çdo proces, në çdo gjykatë të Rrethit Gjyqësor në rang vendi, apo dhe Gjykatat e Apelit, duke ndjekur procedurën ligjore. **Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, ATK është përfaqësuar në 55 procese, ose 238 seanca gjyqësore.**

Shumica e pronave kanë mungesë të infrastrukturës dhe janë në pozicione gjeografike të cilat e bëjnë të vështirë gjetjen e një blerësi potencial.

Nga verifikimet që po realizohen dhe nga përgjigjet e marra nga përmbartuesit, pas vënies në ekzekutim të dosjeve, është evidentuar se shumë nga debitorët kanë ndërruar jetë. Çelja e dëshmisë së trashëgimisë është gjithashtu një proces që kërkon kosto dhe jemi duke bërë vlerësime rast pas rasti në funksion të përfitimit ekonomik që ka Agjencia, duke realizuar arkëtimet me kosto sa më të ulët.

➤ **Sektori i Riskut dhe ankandet**

Sektori i Riskut gjatë Vitit 2021 është fokusuar kryesisht në kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- **Regjistrimin e të dhënave të debitorëve në sistemin provë të Bankës së Shqipërisë**

Në vijim të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, pavarësisht problematikës së hasur në lidhje me funksionimin e sistemit të Bankës së Shqipërisë, gjatë Vitit 2021, kemi arritur të përfundojmë procesin e regjistrimit të skedarëve të debitorëve në portofolin “sistemin provë të Bankës së Shqipërisë”. **Gjithsej janë ngarkuar skedarët e 3,779 debitorëve. Janë regjistruar 7000 debitorë në sistemin e kreditit.**

- **Shqyrtimin e raporteve të vlerësimit të pronave në pronësi të ATK-së**

Gjatë gjithë vitit, sektori ka shqyrtuar raportet e vlerësimit të pronave të ndryshme nën pronësi të ATK-së, për të vijuar më vonë me verifikimin e dosjeve në rast se një pronë do të konsiderohej e përshtatshme për t'u nxjerrë në ankand. Sipas listës së objekteve të sekuestruara deri në datën 31.12.2021, **ATK ka në pronësi 78 prona, ose e shprehur në vlerë 129,294,240.05 lekë.** Ne kemi shqyrtuar raportet e secilës prej këtyre pronave të zonave të ndryshme. Pronat janë analizuar nga ana e pozitës gjeografike, zhvillimit ekonomik të zonës dhe infrastrukturës rrugore.

- **Regjistri Pasiv**

Si detyrë funksionale, janë shqyrtuar dosjet e debitorëve të cilët duhet të regjistrohen në “Regjistrin Pasiv”. Të dhënat e kërkuara lidhen kryesisht me zyrat përmbartimore, urdhërat e ekzekutimit, debitorët me vendim gjykate, kolateralet dhe zonat të cilave ata u përkasin. Kjo është një detyrë që kryhet në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Operacional.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

➤ Strategjia

Strategjia për realizimin e planit u programua edhe në këto detyra:

1. Aplikimi dhe nxjerrja e dokumentave të pronësisë për të gjitha pasuritë e paluajtshme të kaluara në pronësi të ATK-së dhe të freskohen dokumentat e pronësisë për ato pasuri që janë me dokumenta të vjetra pronësie.
2. Grupimin, klasifikimin dhe analizën e portofolit të debitorëve sipas ndarjes territoriale, vlerës së detyrimit, kolateralit dhe statusit ligjor të tyre.
3. Organizimin e grupeve të punës në terren në kontakt me debitorin, trajtimin dhe realizimin e planit të arkëtimeve.
4. Dërgimin dhe ndjekjen çdo muaj pranë zyrave të shërbimit përmbarimor privat ose shtetëror, si dhe rritja e bashkëpunimit me këto zyra.

Stafi aktual i ATK-së, në bashkëpunim edhe me sektorët përgjegjës e ka ndërtuar strategjinë e punës, që të shërbejë jo vetëm në realizimin e një muaji. Për sa më sipër, në lidhje me realizimin e planit të hartuar mes sektorëve dhe angazhimit të Specialist/Jurist dhe Operacional në terren pritshmëritë janë të mëdha. ATK ka ende një numër të konsiderueshëm dosjesh në ekzekutim, apo dhe debitorë të cilët mbahen të evidentuar për t'u kontaktuar nga juristi që mbulon zonën.

Konkluzione: Sipas vlerësimit tonë fokusi i punës së Agjencisë së Trajtimit të Kredive duhet të jetë identifikimi i debitorit dhe kontaktimi i tij. Gjatë Vitit 2021, plani i ATK-së është realizuar në masën 86%, falë një bashkëpunimi mes sektorëve edhe pse ka qenë një vit post-pandemik. Analiza që ka filluar me zona specifike, si dhe orientimi për ndjekje drejt rasteve me propabilitet të lartë të shlyerjes së detyrimit, pritet që të japë rezultat në rritjen e realizimit të arkëtimeve në muajt në vijim, pse jo me pritshmëri edhe më të mëdha se Viti 2021, që ka qenë një nga vitet me realizimin më të madh të ATK-së në 5-vjeçarin e fundit. Nëpërmjet organizimit të brendshëm të punës sistematike dhe vizionare dhe forcimit të kërkesës së llogarisë, frymës së bashkëpunimit mes sektorëve do të krijojmë bindjen, se informacioni i mirë dhe kontrolli përbëjnë çelësin e suksesit në të ardhmen. Vetëm në këtë këndvështrim tërësor, Plani strategjik i ATK-së mund të japë efektin e duhur për drejtimin e inistucionit në vazhdim dhe realizimin e funksionit me sukses.

Duke ju falënderuar, me konsideratë,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

